



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E  
PROJEKTEVE STRATEGJIKE,  
EVROPËS, MIGRACIONIT, DIASPORËS,  
KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENÇES

Nr. 2866 Prot.

Lezhë, më 10.3 .2023

V E N D I M

Nr. 153 datë 10 / 3 / 2023

**“PËR VENDOSJEN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE E EDUKUESE DHE  
RREGULLAT PËR AFISHIMIN E TYRE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE”**

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjin Nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar” neni 79, Dekretin Nr.13864 datë 24.10.2022 të Presidentit të Republikës “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore” si dhe Udhëzimin Nr.6 datë 23.03.2021 të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

V E N D O S A:

1. Përcaktimin e kriterëve për përdorimin e materialeve propagandistike/edukuese dhe përcaktimin e listës së sendeve apo materialeve të lejuara për fushatë, në zbatim të Udhëzimit nr.6 Datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.
2. Vendet e caktuara për afishim në qytetin e Lezhës janë: Rruga “Bulevardi “Gjergj Fishta”, konkretisht tek hapësira midis shkallëve të Gjykatës dhe të Albtelekomit (aty ku sot janë kabinat telefonike), dhe në qendër të të gjitha njësitë administrative.
3. Vendi për vendosjen e materialeve edukuese, që do të afishohen nga palët e treta, që nuk kanë lidhje me subjektet zgjedhore, është caktuar në çdo holl të zyrave të Gjendjes Civile në Bashkinë Lezhë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: Policia Bashkiake, Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit dhe Drejtoria Juridike.

KRYETARI

Pjerin NDREU

